


RAPORT I MONITORIMIT TË AKTIVITETIT TË PROKURIMIT

“PISHINA E PARREGULLSIVE” (Raporti i analizimit të procesit të prokurimit për ndërtimin e pishinës olimpike në Prizren)



Ky raport është hartuar nga Grupi Monitorues i Organizatave Jo-Qeveritare të rajonit të Prizrenit.

Organizatat e Shoqërisë Civile:
EC Ma Ndryshe, ISDY, KDI, OJQ Avoko dhe PRAK Kosova

RAPORT I MONITORIMIT TË AKTIVITETIT TË PROKURIMIT

“PISHINA E PARREGULLSIVE” **(Raporti i analizimit të procesit të prokurimit për ndërtimin e pishinës olimpike në Prizren)**

Monitorues dhe autor: Jeton Qengaj, Anesa Berisha, Edona Muqaj, Erolina Morina,
Eroll Shabani

Fasilitatore: Diana Metushi Krasniqi

Prizren, Maj 2019

PËRMBAJTJA

5	HYRJE
6	METODOLOGJIA
7	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE
8	TRANSPARENCA KOMUNALE
9	ANALIZA E KONTRATËS
9	Faza e parë: PLANIFIKIMI
10	Faza e dytë: PUBLIKIMI
12	Faza e tretë: VLERËSIMI
14	Faza e katërt: ANKESAT
15	Faza e pestë: MENAXHIMI I KONTRATËS
17	KONKLUZION
18	REKOMANDIME

HYRJE

Ky raport është hartuar nga Grupi Monitorues i Organizatave Jo-Qeveritare të rajonit të Prizrenit, të cilët kanë përfituar dije dhe aftësi praktike përmes punëtorive për aplikimin e mësimit mbi monitorimin e prokurimit publik, të organizuara nga Platforma Civikos në kuadër të aktivitetit të USAID Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM).

Pjesëmarrës të serisë së punëtorive ishin:

EMRI DHE MBIEMRI	ORGANIZATA
Jeton Qengaj	AVOKO - Dragash
Anesa Berisha	KDI - Prizren
Edona Muqaj	PRAK - Prizren
Erolina Morina	ISDY - Prizren
Eroll Shabani	Ec Ma Ndryshe - Prizren
Diana Metushi Krasniqi	Lehtësuese e punëtorive

Qëllimet e këtyre punëtorive janë:

(i) Aktivizimi OJQ-ve lokale për të monitoruar tenderët në nivel komunal; (ii) aftësimi i OJQ-ve që të analizojnë gjetjet nga tenderët dhe të zbulojnë keqpërdorimet potenciale në prokurimin publik duke u mbështetur drejtpërdrejt nga lehtësuesit e angazhuar; dhe (iii) OJQ-të të jenë të afta të përgatisin dhe publikojnë raporte mbi gjetjet e tyre gjatë monitorimit e prokurimit publik në nivel komunal.

Gjatë punëtorive Grupi Monitorues kanë përzgjedhur monitorimin e aktivitetit të prokurimit Ndërtimi i Pishinës Olimpikë në Prizren. Të gjeturat nga monitorimi i zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit shpërfaqin nevojën e forcimit të sundimit të ligjit që nga faza e planifikimit të prokurimit e deri të nënshkrimi i kontratës, si dhe ngritjen e përgjegjshmërisë së zyrtarëve publik të cilët janë të përfshirë direkt apo indirekt në iniciimin dhe zbatimin e prokurimit.

Prokurimi publik vazhdon të mbetet një nga shtyllat kryesore të shpenzimit të parasë publike në Kosovë.¹ Raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore shpalosin afërsisht të ndryshme të keqpërdorimeve dhe keq-menaxhimeve të këtyre procedurave në nivel ndërkombëtar. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim në udhëzuesin “Korrupsioni në Prokurim Publik” të vitit 2014 thotë se 10%-30% e investimeve publike në projektet kapitale humbën përmes keq-menaxhimit dhe aferave korruptive. Këto humbje janë mjaft shqetësuese edhe në investimet vendore duke marrë parasysh sido-

¹ Prokurimi publik është një varg veprimesh i ndërmarrë nga Autoritetet Kontraktuese me qëllim të përzgjedhjes së Operatorëve Ekonomik me të cilët do të lidhë një kontratë publike për ofrimin e një malli, shërbimi apo pune (ndërtimi), kundrejt një pagese të financuar nga buxheti i shtetit. Shpenzimet më të bëhen në Shpenzime kapitale, Paga dhe mëditje, Subvencione dhe transfere dhe Mallra dhe shërbime.

mos kualitetin e ulët të punimeve.²

Gjatë viteve të fundit, Qeveria e Kosovës është fokusuar në investime të mëdha kapitale, si ndërtimi i infrastrukturës rrugore, ndërtimi i parqeve të biznesit, investime në energjitikë, si dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive në vend dhe në spektrin ndërkombëtar. Në kuadër të Planit Strategjik për Sportin në Republikën e Kosovës 2017-2021, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për periudhën në fjalë kishte paraparë ndërtimin e dy pishinave olimpike, një në Prishtinë dhe një në Prizren. Në vitin 2017 ishte arritur një marrëveshje mes Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe Komunës së Prizrenit për ndërtimin e Pishinës Olimpikë në Prizren.

Organizatat EC Ma Ndryshe, ISDY, KDI, OJQ Avoko dhe PRAK Kosova mbështetur nga aktiviteti i USAID për komuna transparente, efektive dhe llogaridhënëse kanë analizuar procedurat e prokurimit për këtë projekt për të parë nëse parimet e prokurimit dhe mbarëvajtja e realizimit të projektit janë në përputhshmëri me Ligjin e Prokurimit Publik.

METODOLOGJIA

Grupi Monitorues ka përdorur një metodologji të kombinuar për monitorimin e aktivitetit të prokurimit. Fillimisht Grupi Monitorues përzgjedhjen e tenderit për monitorim e kanë bërë duke u bazuar në indikatorë automatik të përzgjedhjes siç është ai i *“vlera e lartë e projektit”* dhe *“rëndësisë që ka projekti për komunitetin”*. Metodologjia e hulumtimit të këtij raporti në përgjithësi bazohet në analizimin e të dhënave primare të nxjerra nga dokumentet lidhur me procesin e planifikimit, tenderimit dhe dhënies së kontratës, dhe duke i krahasuar ato me dispozitat nga ligji për prokurim publik. Gjithash-tu janë analizuar edhe burime dytësore, si aktivitete të organizatave monitoruese, dhe artikuj nga mediet. Në vazhdim, anëtarët e këtij konzorciumi kanë zhvilluar edhe intervista me zyrtar publik dhe akterë të tjerë për të validuar gjetjet e raportit.

² Investime të arnuara – KDI <http://kdi-kosova.org/ep-content/uploads/2018/01/152-investimet-e-arnuara-7-11-2017-shq-32-fq.pdf>,

Sfidat e Prokurimit Publik në Komunën e Prizrenit – EC ma ndryshe https://ëëë.ecmandryshe.org/repository/docs/181204140403_draft_Sfidat_e_prokurimit_public_n_Komun_n_e_Prizrenit_1_.pdf

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në vitin 2016, në strategjinë për zhvillim, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kishin paraparë edhe ndërtimin e dy pishinave olimprike. Këto pishina do të ndërtoheshin në Prishtinë dhe Prizren, në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me komunat. Me këtë qëllim, në shkurt të vitit 2017, Ministria dhe Komuna e Prizrenit kishin nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e këtij projekti. Kjo marrëveshje obligonte komunën që të siguronte 200,000.00€ për vitin 2017, dhe të zhvillonte procedurat e prokurimit, ndërsa Ministria po ashtu do të siguronte 200,000.00€ të tjera, dhe do të merrej me çështjet e menaxhimit të kontratës.

Në bazë të Memorandumit të sipër cekur dhe vendimit të Kryetarit³, Komuna kishte filluar me vonesë procedurat e prokurimit. Tenderi ishte përgatitur me 19.07.2017, por nuk ishte publikuar deri më datën 24.07.2017, dhe data për pranimin e ofertave ishte 28.08.2017, kështu duke shkelur kërkesat ligjore që tenderi me vlerë të madhe me procedurë të hapur dhe të rregullt të jetë i hapur së paku 40 ditë⁴. Sipas njoftimit për nënshkrim të kontratës, dosjen e tenderit e kishin tërhequr 138 Operatorë Ekonomik, ndërsa kishin tenderuar 11.

Komisioni vlerësues ishin takuar në ditën e 30, apo afatin e fundit të përcaktuar ligjorisht⁵, për vlerësimin e ofertave të pranuar. Ky komision i përbërë nga 3 anëtarë të Kuvendit Komunal të Prizrenit kishte konkluduar se nga 11 ofertat e pranuar, vetëm pesë ishin të përgjegjshme, megjithatë, në raport të vlerësimit nuk ishin cekur arsyet se përse nuk ishin kualifikuar teknikisht gjashtë operatorët tjerë. Përveç kësaj, në tabelën përmbledhëse të ofertave të përgjegjshme ishte shkruar çmimi i ofertës së një operatori të vlerësuar si i papërgjegjshëm në kërkesat e përshtatshmërisë administrative, ndërsa nuk ishte përfshirë çmimi i një operatori ekonomik i cili në të gjitha kërkesat teknike ishte vlerësuar si i përgjegjshëm.

Për këtë vlerësim⁶ kishte pasur një ankesë të shkallës së parë, por zyra e prokurimit e Komunës së Prizrenit e kishte refuzuar si të pabazë. Pas këtij vendimi, pala ankuese kishte deponuar një ankesë në OSHP. Ankesa kishte të bëjë me shkeljet ligjore të trajtimit të barabartë dhe vlerësimit të drejtë të ofertave. Kjo kërkesë ishte aprovuar pjesërisht dhe ishte kërkuar nga Komuna e Prizrenit të ri-vlerësonin ofertat. Komisioni për ri-vlerësim ishte takuar me datën 22.11.2017. Përbërja e komisionit ishte e njëjtë me atë paraprak, dhe kishin vlerësuar në të njëjtën mënyrë sikurse vlerësimi paraprak⁷, veçse

³ Vendimi I Kryetarit të Komunës, i datës 23 maj 2017.

⁴ Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 44 - Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje; paragrafi 2: Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është: (2.1) kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, **jo më pak se dyzet (40) ditë**.

⁵ RREGULLAT DHE UDHËZUESI OPERATIV PËR PROKURIMIN PUBLIK: <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udhëzusi%2010%2004%202019%202.pdf>

⁶ Njoftimi për dhënie të kontratës I datës 02.10.2017

⁷ Njoftimi për dhënie të kontratës I datës 27.11.2017

ishite përmirësuar listimi i çmimeve të ofertave të përgjegjshme ku ishte larguar çmimi i ofertuesit që ishte vlerësuar i papërgjegjshëm, dhe ishte shtuar çmimi i ofertuesit të përgjegjshëm. Pas publikimit të këtij vlerësimi, në OSHP ishin deponuar dy ankesa duke aluduar se operatori ekonomik fitues kishte bashkëngjitur si dëshmi një kontratë fiktive. OSHP kishte kërkuar nga Komuna e Prizrenit, që konform dispozitave ligjore, të kërkoj informata shtesë (në formën e transaksioneve bankare) të cilat do të dëshmonin realizimin e kontratës së dyshuar. Gjatë procesit të rivlerësimit, Komuna e Prizrenit kishte kërkuar informatat shtesë, të cekura paraprakisht, dhe në përgjigje kishte pranuar disa transaksione bankare që janë për ndërtim të pishinës, dhe fletëpagesa në shumën mbi 550,000.00€. OSHP kishte pranuar këto dokumente si dëshmi dhe kishte udhëzuar komunën të vazhdoj me nënshkrimin e kontratës.

Kontrata për ndërtimin e pishinës olimpike ishte nënshkruar me datën 25.04.2018⁸. Plani për menaxhimin e kontratës ishte nënshkruar vetëm nga operatori ekonomik dhe jo edhe nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit siç ishin dakorduar në memorandumin e mirëkuptimit të muajit shkurt 2017. Për më shumë, nuk ishte përcaktuar as menaxheri i kontratës. Në vendimin e datës 23.05.2017, të marr nga kryetari i atëherëshëm i komunës, përveç të tjerave, përgjegjësia për implementimin e këtij projekti i ishte dhënë drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor. Nga muaji janar 2018 deri në muajin mars 2019, organizatat monitoruese kishin vërejtur se në kuadër të këtij projekti ishin bërë vetëm punimet parapërgatitore dhe punimet e dheut, ndërsa në të njëjtën periudhë, Komuna e Prizrenit kishte realizuar dy pagesa në vlerë prej 177,915.30€, për përfundimin e situacionit I (98,309.50€) dhe përfundimin e situacionit II (79,605.50€). Të dy faturat e ofruara nuk kishin dokumente përkatëse si përshkrimi i punëve të përfunduara brenda situacioneve të faturuara dhe raportet e menaxhimit të kontratës që dëshmojnë kryerjen e këtyre punëve në përputhje me kontratën.

TRANSPARENCA KOMUNALE

Me qëllim të realizimit të kësaj analize, Grupi Monitorues i ka parashtruar Komunës së Prizrenit gjithsej pesë kërkesa për dokumente zyrtare. Komuna ka ofruar përgjigje brenda afateve të caktuara kohore në kërkesat tona, megjithatë nuk kishte ofruar qasje në ofertat e të gjithë ofertuesve për këtë kontratë, sic ishte kërkuar. Sa i përket dosjes së tenderit, dokumentet ishin të qasshme në platformën e-prokurimi, megjithatë dokumentet tjera si zotimi i mjeteve, qasja në oferta, raporte të vlerësimit, kontratën, planin e menaxhimit dhe faturat, është dashur të kërkohen përmes kërkesave për qasjen në dokumente zyrtare. Mos publikimi i këtyre dokumenteve ka ndikuar në vonesa në lidhje me analizimin e procedurave. Gjithashtu, Komuna e Prizrenit pranon vetëm kopje fizike të kërkesave për qasje në dokumente publike, dhe nuk pranon kërkesat përmes postës elektronike si kërkesa zyrtare.

⁸ Kontrata me numër të prokurimit 622-17-106-511

ANALIZA E KONTRATËS

Faza e parë: PLANIFIKIMI

Strategjia e MKRS për Sportin në Republikën e Kosovës 2017-2021, si objektiva strategjike në kuadër të modernizimit të infrastrukturës sportive sipas standardeve ndërkombëtare, kishte paraparë edhe ndërtimin e pishinave në qendra regionale. Caktimi i lokacioneve është paraparë të bëhej gjatë vitit 2017, ndërsa implementimi i projekteve të pishinave të realizohej gjatë periudhës 2017-2021.

Në memorandumin e bashkëpunimit⁹ ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ky projekt kapital definohej si investim i përbashkët: MKRS ishte zotuar të financonte 200.000.00 €, ndërsa Komuna për vitin 2017, të siguronte 200.000.00 €.

Sipas kësaj marrëveshje, MKRS gjithashtu do të caktojte projekt menaxherin për monitorimin e kontratës për implementimin e projektit, t'i zotonte mjetet për komunë.

Ndërsa, Komuna e Prizrenit, do të merrte përsipër menaxhimin dhe zhvillimin e të gjitha procedurave të prokurimit për zbatimin e këtij memorandumi, dhe arritjes së qëllimit të tij. Në vazhdim Komuna e Prizrenit obligohej të dorëzonte një kopje të projektit me CD në MKRS dhe në bashkëpunim me MKRS kujdeseshin për implementimin e projektit në fjalë.

Në vazhdim, sipas marrëveshjes së sipër cekur, Komuna e Prizrenit në bashkëpunim me kompanitë kontraktuese obligoheshin që më së largu deri me 20 nëntor të vitit 2017 të dërgonin raportin me stacionet e punëve të realizuara për pagese në MKRS konform Ligjit për Buxhet për vitin 2017. Konform kësaj pike Komuna e Prizrenit duhet të dorëzonte dokumentacionin si në vijim:

- Situacionin përkatës me faturë të aprovuar nga Organi Mbikëqyrës i caktuar nga Komuna e Prizrenit me vendim; Raportin teknik nga organi mbikëqyrës me përshkrim të punimeve të realizuara sipas projektit përkatës, kontratën me operatorin ekonomik me paramasë dhe paralogari sipas kontraktimit të projektit kryesor;
- Shkresën përcjellëse nga Kryetari i Komunës si nënshkrues i Memorandumit për procedim të pagesës në MKRS.

Gjatë analizimit të buxheteve të komunës dhe MKRS për vitet 2017 -2019, Gurpi Monitorues ka gjetur se MKRS deri më tani ka ndarë 1.3 milion €, nga të cilat 900.000.00 janë nga fondi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit përderisa KK Prizren, për të njëjtën periudhë kishte ndarë vetëm 20,000.00 € në vitin 2019.

Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve në nivelin komunal ishte aprovuar me datën 22.06.2017, ndërsa Kërkesë Zotimi për Blerje nga MKRS ishte aprovuar nga Ministria e Financave me datën 21.09.2017, në vlerë prej 130,000.00 Euro për vitin 2017.

⁹ Memorandum Bashkëpunimi, Republika e Kosovës, Nr. i protokollit i MKRS 336/2017, i datës 06.02.2017.

Gjithashtu, edhe pse kjo marrëveshje kishte paraparë që raportet për situacionet e realizuara dhe faturat të dërgoheshin jo më larg se 20 nëntor 2017, kontrata për ndërtimin e pishinës ishte nënshkruar në 25.04.2018, që do të thotë se detyrimet e përcaktuara në marrëveshjen ndërmjet dy institucioneve për vitin 2017 nuk ishin realizuar.

Faza e dytë: PUBLIKIMI

Kuvendi Komunal i Prizrenit më 24 korrik 2017 në platformën e-Prokurimi kishte publikuar 'Njoftim për Kontratë' me numër 622-17-3318-5-1-1 për Ndërtimin e Pishinës Olimpike. Lloji i kontratës ka qenë Punë dhe procedura ka qenë e hapur. Vlera e parashikuar e Kontratës ka qenë 4,000,000.00 euro (vlerë të madhe) kurse afati për dorëzimin e ofertave ka qenë deri më 28 gusht 2017, gjithsej 24 ditë nga dita e shpalljes.

Fushëveprimi i kontratës (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet) ishte ndërtimi i pishinës olimpike, e cila do të përfshijë një sipërfaqe prej 5,000 m² ku do të përdoret material si: gurë të thyer rreth 6,000 m³, dheu rreth 16,000 m³, beton të cilësisë së lartë rreth 20,000 m³ si dhe shumë materiale tjera të cilat janë pjesë përbërëse e projektit për pishinën olimpike

Dosja e tenderit parashihte kriteret e përgjegjshmërisë së tenderit dhe përshtatshmërisë së kontratës si në vijim:

#	Kriteri	Përshkrimi
	Vlera	4,000,000.00
	Kohëzgjatja	36 muaj
I	Kërkesat e përshtatshmërisë	<p>-Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04/L-042.për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 .Neni 65</p> <p>-Në dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës</p> <p>-Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës</p> <p>-Një dëshmi se ju keni përmbushë obligimet e tatimit në pronë së paku deri në muajin paraprak nga data e hapjes së ofertave</p>

2	Për-shtatshmëria profesionale	Regjistrimi si Operator Ekonomik, Regjistrim në TVSH, Regjistrimi i Numrit fiskal
3	Kapaciteti ekonomik dhe financiar	Qarkullimi 3 viteve të fundit jo më pak se 8,000,000.00
4	Kapaciteti teknik dhe profesional	OE të ofrojë dëshmi mbi menaxhimin e ndërtimit të projekteve jo më pak se 6,000,000.00 euro Menaxheri të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë me 5 vite përvojë, OE të ketë dëshmi mbi menaxhimin e ndërtimit të një pishine Në kuadër të stafit të punës duhet të ketë së paku një inxhinjer të elektros me së paku 3 vite përvojë pune, Një inxhinjer të makinerisë me së paku tri vite përvojë pune në profesion, Një inxhinjer të hidros me së paku pes vite përvojë pune në profesion, të ketë së paku 40 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës OE duhet të ketë në pronësi ose posedim pajisjet teknike si në vijim së paku 4 kamiona të tonazhit mbi 10 kubik e. së paku 3 bager të tonazhit të mesëm grupues f. së paku dy cilindër, një i tonazhit të mesëm dhe një të tonazhit të madh.
vc	Kriteri i dhënijes	Çmimi më i lire

Kjo thirrje për tender nuk kërkonte siguri të tenderit, ndërsa siguria e ekzekutimit 10% e vlerës së kontratës për periudhën 37 muaj.

Grupi Monitorues ka gjetur se ky njoftim ishte publikuar me 16 ditë vonesë prej datës së përgatitjes dosjes së tenderit me ç' rast data për dorëzimin e tenderëve nuk ishte përditësuar në dosje të tenderit duke mos përmbushur kërkesën ligjore që tenderët e vlerës së madhe të jenë të hapur për 40 ditë nga njoftimi deri në publikim të tenderit. Kjo do të thotë se shpallja nuk ka plotësuar kriterin e kohëzgjatjes së dërgimit të ofertave, ku kontrata me vlerë të madhe (në këtë rast 4,000,000.00 Euro) ka kohëzgjatje prej 24 ditësh, e sipas LPP duhet të jetë 40 ditë.

Sipas Njoftimit për Nënshkrim të Kontratës, të publikuar me 30.04.2018, dosjen e tenderit e kishin tërhequr 138 Operator Ekonomik.

Faza e tretë: VLERËSIMI

Komuna e Prizrenit kishte pranuar 11 oferta nga operatorët ekonomik për këtë projekt. Gjatë hapjes së ofertave 9 operator ekonomik ishin prezent. Komisioni i hapjes së ofertave ishte i përbërë nga tre anëtarë, dhe nuk ishin evidentuar shkelje gjatë këtij procesi. Komisioni vlerësues¹⁰ ishte mbledhur me datën 27 shtator 2017, respektivisht një muaj pas hapjes dhe leximit të çmimeve të ofertave¹¹ e që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, ku fillimisht vlerësohen ofertat teknike, e pastaj do të bëhet hapja e ofertave financiare¹².

Sipas raportit të vlerësimit të tenderëve, nga 11 ofertat e pranuar, komisioni kishte vlerësuar vetëm pesë oferta si të përgjegjshme.

Gjashtë operator ekonomik ishin të papërgjegjshëm, duke pas shkelje të ndryshme: 7 nga 11 OE kishin përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë administrative, 9 nga 11 kishin përmbushur kriteret e përshtatshmërisë profesionale dhe përshtatshmërinë e pranueshmërisë. Gjithashtu, 8 nga 11 ofertuesit kishin përmbushur kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare, dhe vetëm 6 nga 11 ofertat kishin përmbushur kërkesat për përshtatshmërinë e aftësive profesionale.

Tabela në vijim pasqyron përshtatshmërinë e ofertave individuale për secilin kriter:

	Olti Trasing SH.p.k , Konstruktori ing.1969, SH.p.k SINANI ING Sh.p.k Prishtinë	Raf II sh.p.k, Benita Company sh.p.k ,Xhelal Hajda Toni sh.p.k	KAG – Asphalt Company sh.p.k , Powatec GmbH & Co.KG	N.P.N Albing sh.p.k	N.P.N ÇLIRIMI Korishë- Prizren	SEDTOURS SH.P.K , EUROVIA SH.P.K	I Seferi SH.p.k, ALBOS SH.P.K , N.T.P Niti Gjinoc Suharek	N.T.P Thesar ,A.L.ASFALT shpk Suharekë	DAKI SH.P.K Prishtinë	AL – TRADE SH.P.K Magj. Prishtinë- Ferizaj	Tekno ing consulting shpk , CONEX Group SH.P.K, Rexha SH.p.k, OCEAN PISHINË& SPA SH.P.K Prishtinë
Kërkesat e përshtatshmërisë administrative	PO	JO	PO	PO	PO	JO	PO	PO	JO	PO	JO

¹⁰ Rapoti i Vlerësimit të Tenderëve data. 27.09.2017

¹¹ Procesverbali i hapjes së ofertave, i datës 28.08.2017

¹² Rr.UOPP, Neni 48, paragraphët 48.7 (Fillimisht, vlerësohen vetëm propozimet teknike,) dhe 48.8 (Në fund të vlerësimit të Propozimeve Teknike, Autoriteti Kontraktues do t'i ftojë tenderuesit të cilët kanë dorëzuar Propozime Teknike të përgjegjshme dhe të cilët janë caktuar si të kualifikuar për dhënie që të marrin pjesë në hapjen e Propozimeve Financiare.)

Siguria e tenderit	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	PO	PO	PO	JO	PO	PO	PO	PO	JO	PO	PO
Kërkesat për përshtatshmërinë e pranueshmërisë	PO	PO	PO	JO	PO	PO	PO	PO	JO	PO	PO
Kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare	PO	PO	PO	JO	PO	JO	PO	PO	JO	PO	PO
Kërkesat për përshtatshmërinë e aftësive profesionale	PO	PO	PO	JO	PO	JO	JO	PO	JO	PO	JO
OE i Përgjegjshëm	PO	JO	PO	JO	PO	JO	JO	PO	JO	PO	JO
Oferta Financiare	2,784,667.78 €	3,389,021.32€	3,577,777.77 €		2,499,570.30€					3,137,212.07€	

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, Grupi Monitorues ka gjetur se në vlerësimin për kërkesat e përshtatshmërisë administrative mungonin sqarime lidhur me mos-përbushjen e kriterit për katër operator ekonomik¹³.

Gjithashtu, edhe pse raporti pasqyron se oferta e konzorciumit “N.T.P Thesari dhe A.L ASFALT SH.PK” të ketë përbushur kriteret e përshtatshmërisë teknike megjithatë oferta financiare nuk është paraqitur tek kriteri i çmimit.

Po ashtu, tek ofertat financiare ishte listuar edhe çmimi i konzorciumit Rafi II sh.p.k, Benita Company sh.p.k ,Xhelal Hajda Toni sh.p.k, edhe pse nuk kishte përbushur të gjitha kriteret e përshtatshmërisë.

Në raportin e vlerësimit të ofertave mund të vërejmë se kemi një vlerësim të përgjithësuar dhe pa sqarime rreth eliminimit të tenderuesve. Komuna e Prizrenit nuk kishte ofruar qasje në ofertat e të gjithë operatorëve ekonomik, prandaj nuk kemi arritur të analizojmë nëse çmimet e Operatorëve Ekonomik të eliminuar ishin më të favorshme.

Pas publikimit të “Njoftimit për Dhënie të Kontratës” përkatësisht rekomandimit për kontratë nga Komuna, ka pasur shumë “kërkesa për rishqyrtim” bazuar në nenin 108/A nga operatorët ekonomik, të cilat ishin refuzuar me arsyetim se kanë qenë pretendime jo të qëndrueshme.

¹³ KAG – Asphalt Company sh.p.k , Powatec GmbH & Co.KG , N.P.N Albing sh.p.k, Raf II sh.p.k, Benita Company sh.p.k ,Xhelal Hajda Toni sh.p.k

Pas ankesave nga OE¹⁴, me vendim të OSHP-së komisioni vlerësues ishte ri-takuar përsëri me datën 22.11.2017. Anëtarët e komisionit vlerësues gjatë vlerësimit të parë ishin nga KK Prizrenit dhe kishin këto kualifikime: profesor i edukatës fizike, inxhinier i komunikacionit dhe arkitekt, kurse gjatë rivlerësimit, anëtarët ishin nga KK Prizren me këto kualifikime: njëri ishte profesor i edukatës fizike, dhe dy anëtarët e tjerë ishin inxhinier të komunikacionit. Duke u bazuar në faktin se ndërtimi i Pishinave Olimpikë është një punë komplekse, grupi monitorues ngritë shqetësime që asnjëri nga anëtarët e komisionit vlerësues nuk është inxhinier i ndërtimtarisë apo inxhinier hidroteknik/hidro sanitar¹⁵ të cilët do të ishin të familiarizuar me kriteret ndërtimore të pishinave olimpikë¹⁶. Edhe pse OSHP kishte dërguar lëndën në rivlerësim, vendimi i komisionit kishte mbetur i njëjtë, dhe sikurse në vlerësimin paraprak, mungonin sqarimet për klasifikimin e operatorëve ekonomik të pa përgjegjshëm.

Faza e katërt: ANKESAT

Për këtë tender, Operatorët Ekonomik ishin deponuar 3 ankesa në OSHP, ankesa e parë ishte bërë nga “KAG ASPHALT COMPANY” Sh.p.k & POWATEC GMBH, 7 ditë pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës. I njëjti ishte ankuar edhe në nivelin e parë, me ç’ rast Komuna e Prizrenit i kishte refuzuar ankesën si të pa bazë. Përmes kësaj ankesë “KAG ASPHALT COMPANY” Sh.p.k & POWATEC GMBH pretendonte se AK kishte shkelur parimet e përgjithshme të prokurimit publik duke shkelur kriteret e vlerësimit të drejtë të ofertave duke mos vlerësuar drejtë ofertat kundrejt kriterëve të përshtatshmërisë si dhe mos trajtimin e ofertës jo normalisht të ulët.

Eksperti i OSHP-së pas shqyrtimit të ankesës nga “KAG ASPHALT COMPANY” Sh.p.k & POWATEC GMBH kishte shprehur mendimin se KK Prizren nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP, prandaj rekomandonte anulimin e vendimit të AK për dhënie të kontratës dhe njëkohësisht ankesën e OE ankues ta aprovojë pjesërisht si të bazuar dhe njëherit propozonte që ky aktivitet i prokurimit të rivlerësohet. Ky rekomandim ishte mbështetur nga vendimi i parë i OSHP-së, i cili e kthen lëndën në rivlerësim.

Pas ri-vlerësimit të ofertave nga KK Prizren dhe publikimit të dytë të njoftimit për dhënie të kontratës, në OSHP ishin deponuar edhe dy ankesa lidhur me vendimin e AK, respektivisht nga “KAG ASPHALT COMPANY” Sh.p.k & POWATEC GMBH dhe “Rafii sh.p.k.”, të cilët shprehnin shqetësime lidhur me përgjegjshmërinë e ofertuesit të përzgjedhur për këtë projekt. Shqetësimet e këtyre OE vazhdonin të ishin të lidhura me shkeljet e parimeve të përgjithshme të prokurimit publik duke shkelur kriteret e vlerësimit të drejtë të ofertave duke mos vlerësuar drejtë ofertat kundrejt kriterëve të përshtatshmërisë si dhe mos trajtimin e ofertës jo-normalisht të ulët.

Në vazhdim ankesat e këtyre OE shprehnin shqetësime lidhur me validitetin e një kontrate të ofruar nga OE fitues për ndërtimin e një pishine private, si dëshmi e përvojës,

¹⁴ Shih Faza e Katërt: Ankesat

¹⁵ RrUOPP, Neni 40, paragrafi 40.5 “Komisioni do të përbëhet nga anëtar me aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë, relevante “me kërkesat e prokurimit;”

¹⁶ Kriteret ndërtimore të pishinave olimpikë përcaktohen sipas standardeve të Federatës Ndërkombëtare të Notit, FINA, dhe ISO 9001.

e cila ishte shfrytëzuar si bazë për kualifikimin profesional të kritereve përzgjedhëse.

Megjithatë, gjatë shqyrtimit të ankesës dhe vlerësimit të ekspertit, nuk është marr për bazë fakti se kontrata me një individ privat ndërmjet N.P.N. Çlirimi dhe Sejdi Rexha, nuk ka qenë e listuar në listën e projekteve të ngjashme, të paraqitura nga po i njëjti ofertues.

Po ashtu, në procesverbalin e seancës para vendimit të OSHP-së numër 378-17, përfaqësuesi i Komunës së Prizrenit kishte deklaruar se: “Ka përfunduar një pishinë në vitin 2014, dhe ka ofruar edhe një kontratë me një referencë dhe me një dëshmi se pronari i pishinës Sejdi Rexhaj, ka një kontratë me “Çlirimin”, ka përfunduar një pishinë në vitin 2014, dhe se është i kënaqur me punimet që janë realizuar nga ky OE.” Kjo deklaratë është kontradiktore me kontratën dhe dëshminë e prezantuar, meqë kontrata është nënshkruar në vitin 2014 dhe sipas referencës së prezantuar është përfunduar në vitin 2015 e jo ashtu siç është deklaruar nga përfaqësuesi i AK, në vitin 2014. Vendimi i OSHP 378-17 kërkon nga KK i Prizrenit që të vërtetoj transaksionet (dëshmitë) bankare lidhur me këtë projekt. Në përgjigje të kësaj kërkesë, KK Prizren kishte pranuar dhe paraqitur si dëshmi në OSHP fletëpagesa në shumën mbi 550,000.00€, prej të cilave 161,900.00 janë kompensim me makineri të rëndë, për të cilat nuk ishte prezantuar dokumentacion i ndërrimit të pronësisë, si dhe për pjesën tjetër të pagesave me para të gatshme, për të cilat nuk është prezantuar ndonjë raport bankar. Gjatë seancës së mbajtur lidhur me ankesën 502-17, dhe vendimin e marrë për të njëjtën, edhe pse OSHP kishte dhënë një vendim, i cili ishte plotësuar vetëm pjesërisht, atë e ka marrë si të pranueshëm, duke rekomanduar që KK Prizren të vazhdoj me dhënien e kontratës ashtu siç e kishin përzgjedhur fillimisht.

Gjatë këtij hulumtimi, lidhur me brengat e ngritura lidhur me kontratën e sipër cekur, organizatat monitoruese kishin kërkuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor vendimin për legalizimin e pronës në fjalë, me ç'rast, kjo drejtori ishte përgjigjur¹⁷ se nuk ekzistonte një vendim i tillë ashtu siç nuk ekzistonte as edhe një kërkesë nga pronari për legalizimin e saj. Për më shumë, në Prill 2019, Prokuroria Themelore e Prizrenit kishte ngritur një aktakuzë kundër pronarit të kompanisë fituese për mashtrimin me dokumentin në fjalë, që kishte shërbyer si bazë për vlerësimin e përgjegjshmërisë së tenderit për ndërtimin e pishinës olimpike.

Faza e pestë: MENAXHIMI I KONTRATËS

Autoriteti Kontraktues si pjesë të përgatitjes së aktivitetit të prokurimit duhet të prodhojë një plan të menaxhimit të kontratës në mënyrë që përmbushja e detyrimeve të përkojë me objektivat e kontratës.

Plani i Menaxhimit të Kontratës për Pishinën Olimpikë nuk ishte plotësuar sipas kërkesave ligjore, ku përveç se nuk ishin dhënë Detajet e Implementimit të kontratës, plani ishte nënshkruar vetëm nga Menaxheri i Projektit i Operatorit Ekonomik, mirëpo nuk ishte nënshkruar nga menaxheri i projektit nga Autoriteti Kontraktues. Ky fakt dëshmon se plani ekzistues nuk është i vlefshëm pasi që mungon një vullnet i dakorduar mes dy palëve në fjalë. Madje, Autoriteti Kontraktues ende nuk ka caktuar një Menaxher të Kontratës.

¹⁷ Përgjigja nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Nr. 04-034/01-136216, e datës:

Në shtator 2018 MKRS, dhe Drejtoria e MKRS në Prizren kanë inspektuar punimet e Pishinës Olimpike. Sipas inspektimeve të bëra kanë deklaruar se punimet janë duke u zhvilluar sipas planit dinamik.¹⁸

Për shkak të motit jo të favorshëm, deri në kohën e realizimit të këtij hulumtimi (31 mars 2019), nuk kishte pasur punime të tjera¹⁹.

Sipas kontratës së nënshkruar, paramasa dhe paralogaria parashihte pesë pjesë realizuese:

#	Përshkrimi i punëve	Vlera në Euro
a. Punimet ndërtimore		€ 1,253,343.70
1	Punimet parapërgatitore	€ 6,905.00
2	Punimet e dheut	€ 102,238.50
3	Punimet e Muratimit	€ 107,155.00
4	Punimet e betonit dhe beton armës	€ 542,533.20
5	Punimet Armiruese	€ 243,216.00
6	Punimet e konstruksionit të kulmit	€ 154,296.00
7	Punimet e mbulesës	€ 97,000.00
b. Punimet e zejtarisë		€ 675,625.00
8	Punimet e izolimit	€ 107,430.00
9	Punimet e zdrukthtarisë	€ 15,360.00
10	Punimet axhustatorisë	€ 241,010.00
11	Punimet e Lllamarinës	€ 9,120.00
12	Punimet e qeramikës	€ 159,770.00
13	Punimet e mermerit	€ 43,260.00
14	Punimet e llyerjes dhe ngjyrosjes	€ 13,440.00
15	Punimet e llaminatit	€ -
16	Punimet e fasadës	€ 49,200.00
17	Punimet të ndryshme	€ 37,035.00
C	Punimet e instalimit të ujësjellësit, kanalizimit dhe filtrimi	€ 79,266.66
D	Punimet e instalimeve elektrike	€ 100,575.00
E	Punimet e instalimeve të ngrohjes dhe ventilimit	€ 293,040.94
F	Bazeni 01	€ 97,899.00
Vlera totale		€ 2,499,750.30

20.03.2019

¹⁸ <https://kallxo.com/pishina-olimpike-ne-prizren-po-ndertohet-sipas-planit/>

¹⁹ Në kohën e zhvillimit të këtij monitorimi, në terren ishte realizuar vetëm pastrami i një pjese të punishtes, dhe hapja e gropes së pishinës.

Deri në fund të muajit mars 2019, Komuna e Prizrenit kishte realizuar dy pagesa kundrejt realizimit të këtij projekti në vlerën prej 177,915.30€.

Fatura e parë me numër 106/01-10F e datës 19.12.2018 në shumën prej 98,309.50€ (me TVSH) ishte për përfundimin e situacionit 1, dhe;

Fatura e dytë me numër 106/02-10F e datës 21.12.2018 në shumën prej 79,605.50€ (me TVSH) ishte për përfundimin e situacionit 2.

Faturat në të cilat i ishte dhënë qasje organizatave monitoruese nuk përbënin edhe raportin e punëve të përfunduara. Duke u bazuar në përshkrimet e më sipërme në paramasën dhe paralogarinë e çmimeve të kontratës, ka qenë e pa mundur të vërtetohet nëse punët e faturuara ishin përfunduar, si dhe faturat e paguara nuk përputhen me pjesët e sipër cekura të paramasës dhe paralogarisë.

KONKLUZION

Kjo kontratë ishte ballafaquar me probleme që nga fillimi.

- Tenderi ishte hapur në qershor të vitit 2017 dhe për shkak të ankesave në këtë proces, nënshkrimi i kontratës ishte bërë pas 10 muajve. Kjo ka ndikuar në mos përbushjen e strategjisë dhe marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Prizrenit, e cila parashihte që projekti të fillonte në tremujorin e katërt të vitit 2017.
- Publikimi i dosjes së tenderit ishte ballafaquar me vonesa. Sipas Njoftimit për Kontratë, të publikuar në e-Prokurimi, dosja ishte përgatitur me 19.07.2017, por nuk ishte publikuar deri më datën 24.07.2017, dhe data e fundit për pranimin e ofertave ishte 28.08.2017. Ligji për prokurim publik, për kontratat e vlerës së madhe me procedurë të hapur, të rregullt, parashihet afatin për dorëzimin e tenderëve brenga 40 ditësh nga publikimi. Mungesa e një planifikimi të mirëfillt të afateve kohore për përbushjen e kërkesave ligjore kishin rezultuar në mos përbushjen e kërkesave ligjore²⁰ për afatet për katër ditë më pak se që kërkohet.

Edhe gjatë procesit të vlerësimit ishin vërejtur parregullsi të ndryshme, duke filluar në:

- Vlerësimin si të pa përgjegjshëm në kriteret e përshtatshmërisë administrative për katër kompani, pa treguar arsyet e këtij vlerësimi. Për më shumë, në listën e pesë kompanive të vlerësuara si të përgjegjshme figuron edhe çmimi i një OE të vlerësuar si i papërgjegjshëm, ndërsa mungon çmimi i OE, oferta e të cilit ishte vlerësuar si e përgjegjshme. Komuna e Prizrenit nuk kishte ofruar sqarime lidhur me këto ndryshime. E ankesa lidhur me këtë proces kishte pasur edhe në Komunën e Prizrenit, edhe në OSHP. Ankesat ishin lidhur me përgjegjshmërinë e OE të përzgjedhur si fitues i tenderit. Palët ankuese kishin shprehur dyshime lidhur me një kontratë që kishte prezantuar OE fitues, me një person privat, e cila ishte bazë e përgjegjshmërisë së tij në përbushjen e kërkesave për përshtatshmërinë e aftësive profesionale.
- Komuna e Prizrenit nuk e kishte marr parasysh ankesën, si dhe OSHP kishte

²⁰ Ligji për prokurim publik

pranuar dëshmitë e mangëta (fletëpagesa në vlerë të 550,000€ dhe jo transfere bankare) të prezantuara nga Operatori Ekonomik përmes Autoritetit Kontraktues, dhe duke mos i verifikuar ato më tutje.

- Grupi Monitorues më vonë kishte gjetur se rreth asaj kontrate, në Prill 2019, Prokuroria Themelore në Prizren kishte ngritur aktakuzë kundër pronarit të kompanisë. Për më shumë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e vet komunës së Prizrenit kishte deklaruar se nuk kishte pranuar kurrë një kërkesë për leje ndërtimi apo legalizim të pronës që ishte subjekt i kësaj kontrate të dyshimtë.

Probleme kishte edhe në fazën e menaxhimit.

- Marrëveshja ndërmjet MKRS dhe KK Prizren kishte paraparë që MKRS të përcaktonte menaxherin e kontratës, por që menaxhimi i kontratës duke përfshirë edhe pagesat kishte mbetur në mënyrë informale në përgjegjësi të komunës.
- Kjo kontratë nuk ka një plan menaxhimi, meqë plani i menaxhimit, i obligueshëm sipas ligjit për prokurim publik, ishte nënshkruar vetëm nga Operatori Ekonomik, po nuk ishte nënshkruar nga niveli kontraktues, respektivisht as komuna e as ministria.

REKOMANDIME

1. Zyra e prokurimit e Komunës së Prizrenit në prokurimet e ardhshme t'i kushtoj rëndësi afateve kohore të përcaktuara me ligj, dhe në rast të mos ketë vonesa të përditësoj datat sipas situatës.
2. Udhëheqësi i Prokurimit nuk duhet të pranojë raporte të mangëta të Komisioneve Vlerësuese.
3. Komisionet vlerësuese duhet të japin sqarime secilin Operator Ekonomik të eliminuar në mënyrë të detajuara për kriteret e papërmbushura të ofertuesve.
4. Kryetari i Komunës dhe në mënyrë direkte Udhëheqësi i Prokurimit duhet të shqyrtojë me kujdesë secilën kërkesë për rishqyrtim që vije nga bizneset në mënyrë që të parandalohen lëndët që të shkojnë në OSHP duke shkaktuar vonesa të panevojshme. Shkeljet eventuale duhet të identifikohet nga Komuna dhe të adresohen menjëherë.
5. OSHP duhet të tregohet më e dedikuar në eliminimin e parregullsive, sidomos duke rritur me bashkëpunimin me institucionet përkatëse. Sikurse OSHP të komunikonte me ATK apo organet e drejtësisë, do të mund të dëshmohej para hyrjes në detyrime nëse oferta fituese, e kontestuar nga palët ankuuese në OSHP, ishte e përgjegjshme apo jo. Mungesa e këtij bashkëpunimi mund të rrezikoj implementimin e kontratës.
6. Prokuroria themelore e Prizrenit duhet që sa më shpejtë të hetoj dyshimet e ngritura lidhur me kontratën me një person privat, që ishte përdorur për përfitimin e fondeve publike.

-
7. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit duhet të komunikoj me Komunën e Prizrenit, dhe të krijohen linjat e koordinimit për menaxhimin e kontratës.
 8. Komuna e Prizrenit duhet të mbajë të bashkëngjitur me faturën përshkrimin e situacionit të përfunduar dhe raportin e menaxherit për kompletimin e punëve.



